



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 99, Datë 30.04.2018**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KODIT TË RRJETIT PËR KËRKESAT E LIDHJES ME RRJETIN TË SISTEMEVE ME TENSION TE LARTE ME RRYME TË VAZHDUAR DHE PARQET ME MODULE TË ENERGJISË TË LIDHUR ME RRYMË TË VAZHDUAR (HVDC)**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 23, gërma “b” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016” si dhe parashikimeve të Vendimit nr. 2018/04/PHLG-EnC, datë 12.01.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 30.04.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e Kodit të rrjetit për kërkesat e lidhjes me rrjetin të sistemeve me tension të lartë me rrymë të vazhduar dhe parqet me module të energjisë të lidhur me rrymë të vazhduar (HVDC),

**Dhe pasi mori në konsideratë:**

- Se Shqipëria është anëtare e Komunitetit të Energjisë që nga data 01.07.2006;
- Rregulloren e (BE) nr. 714/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës;
- Kërkesat e Rregullores së Komisionit (KE) 2016/1447 e datës 26 Gusht 2016 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës;
- Vendimit nr. 2018/04/PHLG-EnC, datë 12.01.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë;
- Parashikimet e Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”;
- Certifikimin operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a;
- Operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a është anëtare me të drejta të plota e ENTSO-E;
- Sipas Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ky Kod propozohet për miratim në ERE nga OST sh.a dhe duhet të transpozohet pa ndryshuar tekstin apo strukturën e tij. Dispozitat e këtij Kodi do të prevalojnë ndaj Kodit të Transmetimit miratuar me vendimin nr. 186, datë 10.11.2017, të bordit të ERE dhe çdo akti tjetër rregullator i sektorit të energjisë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për miratimin e Kodit të rrjetit për kërkesat e lidhjes me rrjetin të sistemeve me tension të lartë me rrymë të vazhduar dhe parqet me module të energjisë të lidhur me rrymë të vazhduar (HVDC).
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**